



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 499/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, paraqitur kundër Arlind Gjashtgishti nga Prizreni për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, LVV-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se, me 03. Nëntor 2013, në vendvotimin 2042A 07R, personi Arlind Gjashtgishti ka tentuar që të votojë më shumë se një herë, për më tepër ka shtuar se këtë veprim e kishte vërejtur edhe komisionari i AAK-së i cili ka reaguar për ta ndaluar këtë tentim votim

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 të LZP-së parashihet se : *“Mund të apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Me ankesën e parashtruar nga LVV-ja pretendohet se kanë ndodhur pa rregullsi në VV me rastin e votimit nga personi Arlind Gjashtgishti, i njëjti kishte tentuar që të votojë më shumë se një herë, mirëpo një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i paqartë për tu vërtetuar .

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, pasi që mungojnë provat me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 499/2013 më datën 07.11.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.